




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>03</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4547/12</u> Prot No. Data Datum <u>19-12-2012</u> Date PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	19.12.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-
PËR/ZA/TO:	z. Zeqir Selmani Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit
CC:	z. Besim Ilazi Kryetar i Komunës së Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat, zjarrfikësit dhe shëndetësinë"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin publik me titull "Furnizimi me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat, zjarrfikësit dhe shëndetësinë" me nr. prokurimit KA-652-12-062-121 ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, (në tekstin e mëtejme AK), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik "Furnizimi me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat, zjarrfikësit dhe shëndetësinë", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Komunën e Kaçanikut, si autoritet kontraktues, në njoftimin për kontratë të publikuar në UEB faqen e KRPP-së me kontratë "Furnizim" të procedurës së hapur vlerë e mesme me nr. prokurimi KA -652- 12-062-121 dhe titull tenderi "Furnizimi me material harxhues-administrativ për SHICK-ën, shkollat, zjarrfikësit dhe shëndetësinë" te pika III.2.2 Kapaciteti Ekonomiko Financiar ka kërkuar: Kartelën Bankare dhe ndonjë dëshmi tjetër për qarkullim financiar, mirëpo të njëjtën kërkesë nuk e ka inkorporuar në Dosje të tenderit dhe në Raportin e Vlerësimit, nga kjo rrjedh se departamenti i prokurimit ka bërë shkelje të nenit 27 LPP-së 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve ka vlerësuar operator si te përgjegjshëm administrativisht edhe pse dokumentacionet e ofruara nga operatorët nuk ishin sipas kushteve të parapara në dosjen e tenderit.

Operatori Ekonomik "ERA" ka ofertuar për të dy (2) loto, - O.E ka ofruar kontrata prej institucioneve të ndryshëm por jo edhe referenca dhe dëshmi të pagesës ashtu siç janë kërkuar nga autoriteti kontraktues.

A.K te Seksioni II Fleta e të Dhënave të tenderit (FTD) neni 22.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë- O.E te pjesa C – Formulari i dorëzimit të tenderit pika 4, ka ofruar afat të vlefshmërisë vetëm 60 ditë.

O.E nuk posedon: Kartelën Bankare dhe ndonjë dëshmi tjetër për qarkullim financiar e cila është kërkuar në Njoftimin për Kontratë të UEB faqes së KRPP-së.

Operatori Ekonomik "ABETARE-ES" – ka ofertuar vetëm për Loton I, dhe ky operator ka ofruar vetëm një referencë të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut të datës 12.11.2012 sipas kontratës me nr. 09/07 të datës 27.07.2007, por nuk ka ofruar kontrata dhe dëshmi te pagese ashtu siç është kërkuar.

A.K te Seksioni II . Fleta e të Dhënave të tenderit (FTD) neni 22.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë O.E te pjesa C – Formulari i dorëzimit të tenderit pika 4, nuk ka ofruar fare vlefshmërinë e tenderit.

O.E" ELITA – IT" - ka ofertuar për të dy (2) loto, dhe ky operator ka ofruar një (1) referencë të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut dhe kontratën por jo edhe dëshmi të pagesës ashtu siç është kërkuar.

A.K te Seksioni II . Fleta e të Dhënave të tenderit (FTD) neni 22.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë- O.E te pjesa C – Formulari i dorëzimit të tenderit pika 4, nuk ka ofruar fare vlefshmërinë e tenderit.

A.K me rastin e vlerësimit të tenderit në fjalë nuk ka bere vlerësim sipas LPP-së ngase ka vlerësuar ofertat e Operatorëve Ekonomik si të kompletuara për nga dokumentacioni edhe pse pas kontrollimi vlerësimit dhe krahasimit të ofertave vërehet se këta ofertues nuk kanë dokumentacionin e kompletuar.

Andaj Autoriteti Kontraktues me veprimet e tilla ka shkelur Ligjin nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozitë

- Dispozitën e nenit 59 respektivisht nenit 32 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Me respekt!